



01 Nr. 480/25 Dt. 05.08.2025



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Beledijesi

Në bazë të nenit 13 dhe nenit 58 paragrafi g, të Ligjit nr. 03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008), në mbështetje të zbatimit të veprimit 3.2 të Planit të Veprimit 2022-2024, të Programit për Parandalimin dhe Zvogëlimin e Barrës Administrative 2022-2027, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, nr. 27.29 të datës, 14.09.2022, dhe nenit 51 të Statutit të Komunës së Prizrenit nr. 01/011-5643, të datës 15.10.2008, kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR PROCESIN E BARRËS ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË KOMUNËS SË PRIZRENIT

1. Atdhe Çadraku- zyrtar ligjor Komunën e Prizrenit, caktohet si zyrtar përgjegjës për procesin e barrës administrative në kuadër të Komunës së Prizrenit.
2. Përgjegjësitë e zyrtarit përgjegjës për procesin e barrës administrative janë:
 - 2.1. Koordinimi i procesit të barrës administrative brenda komunës;
 - 2.2. Komunikimi, përfaqësimi dhe koordinimi me Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, për mbarëvajtjen e procesit të barrës administrative, në kuadër të komunës;
 - 2.3. Pjesëmarrja dhe kontrollimi i politikave publike të zhvilluara nga Komuna, në kontekst të procesit të barrës administrative.
3. Me këtë Vendim shfuqizohet vendimi nr. 01 nr. 445/25, i datës 23.07.2025.
4. **Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës në Shërbimin Civil, në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi.
5. Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit të tij.

Kryetari i Komunës
Shaqir Totaj

- Vendimi iu dërgohet:
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal,
 - Të lartcekurit,
 - Arkivës së Kryetarit.

